



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 353/1 prot.

Tiranë, më 24.02.2021

**VENDIM**  
**Nr.17, datë 24.02.2021**

**PËR**  
**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË**  
**VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 197, DATË 21.12.2020**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 197, datë 21.12.2020, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ për verifikimin e ligjshmërisë të informacionit, për emërim të përkohshëm, të parregullt, të nëpunësit \*\*\*\*\*, në një pozicion pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në të cilin kërkohet çertifikata e sigurisë nga DSIK.”.

**KONSTATOVA SE:**

Nëpërmjet informacionit të ardhur me email, protokolluar me nr. 743 prot., datë 28.09.2020, janë ngritur pretendime se, nëpunësit \*\*\*\*\* , i emëruar përkohësisht në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Inteligjencës Operative”, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, i është refuzuar çertifikata e sigurisë nga ana e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe aktualisht, megjithëse ky pozicion pune e kërkon pajisjen me një dokument të tillë, ai vazhdon në këtë detyrë, prandaj është kërkuar ndërhyrja e Komisionerit, për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë.

Për verifikimin e informacionit, Komisioneri, ka kryer hetimin administrativ të këtij rasti duke kërkuar nga institucioni Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të gjithë materialin shkresor që pasqyron veprimet administrative të kryera për transferimin e këtij nëpunësi dhe njohjen me ligjin organik të institucionit për të konkluduar nëse pozicioni i punës duhet të pajiset me “Çertifikatën e Sigurimit të Personelit” (CSP).

Në përfundim të këtij hetimi administrativ procesi është përmbyllur me Vendimin nr.197, datë 21.12.2020, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e hetimit administrativ për verifikimin e ligjshmërisë të informacionit, për emërim të përkohshëm, të parregullt, të nëpunësit \*\*\*\*\*, në një pozicion pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në të cilin kërkohet çertifikata e sigurisë nga DSIK”*.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, njësia përgjegjëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, ka informuar Komisionerin me shkresën nr. 23476/3 prot., datë 14.01.2021, *“Kthim përgjigje”* në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues, duke bashkëngjitur dokumentacionin që provon zbatimin e tij.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 197, datë 21.12.2020, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin objekt i hetimit administrativ paraqitet si më poshtë vijon:

Komisioneri ka kërkuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të shfuqizojë urdhrin nr. 17031, datë 15.9.2020, për transferimin e përkohshëm të nëpunësit \*\*\*\*\* në pozicionin *“Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Inteligjencës Operative”*, në Drejtorinë e Informacionit, Analizës së Riskut dhe Monitorimit, duke e kthyer nëpunësin në pozicionin ku ai ka punuar para këtij transferimi.

Konstatova se, nga ana e institucionit janë marrë masa për rikthimin e gjendjes së ligjshmërisë, duke e kthyer nëpunësin në pozicionin e mëparshëm me Urdhrin nr. 23876/2 prot., datë 11.01.2021, *“Rikthim në detyrën e mëparshme”*, konkretisht në pozicionin *“Përgjegjës Zyre”*, Zyra e Terminalit të Trageteve, Sektori i Operacioneve Doganore në Terminalin e Trageteve, Anijeve, Kontenierëve, pranë Degës Doganore Durrës.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 197, datë 21.12.2020, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e hetimit administrativ për verifikimin e ligjshmërisë të informacionit, për emërim të përkohshëm, të parregullt, të nëpunësit \*\*\*\*\*, në një pozicion pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në të cilin kërkohet çertifikata e sigurisë nga DSIK.”*

2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 197, datë 21.12.2020.
3. Për këtë vendim të njoftohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe nëpunësi  
\*\*\*\*\*.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**